



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 71

Prishtinë, më 04 mars 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Mufera Şinik, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Behar Selimi, Arsim Bajrami dhe Albulena Haxhiu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Petrit Hysaj – OSBE, Visar Smajlaj – ekspert, Sylë Ahmeti – Kosova Sot, Lejla Selimi – OSBE, Vlora Marmullakaj – EULEX, Sahadete Zogaj – Kosova Pres, Artan Canhasi – EULEX, Driton Selmanaj – KDI, Labinot Lepashtica – UNDP, Shqipe Menisi, Burbuqe Berisha dhe Rebeka Maliqi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi , kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 08.02.2013;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-155 për sistemin e pagesave;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-189 për ndryshimin plotësimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve;

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në pikën të ndryshme të futet edhe:

- Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara nga kryetari.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 08.02.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 08.02.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit

Kryetari – Tha se ky projektligj ka ngjallur shumë debate dhe diskutime, për të cilin janë bërë edhe shumë vërejtje dhe amendamente. Kjo pikë e rendit të ditës ishte paraparë për javën e kaluar, mirëpo pasi që Ardian Gjini mungoi dhe kishte disa amendamente që i kishte propozuar, ne, si Komision, vendosëm që ta shqyrtojmë në këtë mbledhje.

Ardian Gjini – Ai sqaroi amendamentet e propozuara, duke shtuar se amendamenti parë ka të bëjë me një lloj të duhanit, ose disa lloje siç janë; duhani puro, duhani i llullës, dhe ai për mbështjellje. Theksoi se as një vend në botë nuk i ndalon, sepse janë produkte që përdorën, e nëse ne i ndalojmë atëherë e krijojmë mundësin e kontrabandës. Komisioni nuk e ka mbështetur këtë projektligj, i cili ekskluzivisht ka të bëjë me një produkt që prodhohet në tërë botën dhe nuk është i ndaluar. Çështja tjetër ka të bëjë me gjendjen të cilën po kalojmë ne duke shtuar se secili biznes duhet të deklarojë se në lokalitetin e tij lejohet pirja e duhanit, duke paguar një taks shtesë, e nëse atëherë nuk i përmbahet ligjit, ai bënë dy shkelje, për mos zbatim të normave dhe ikjes së tatimit. Mund të them se në një kohë shumë të shkurtër ka me qenë demode shkuarja në ato vend ku pihet duhani, po ashtu edhe çmimet do të jenë më të larta.

Gëzim Kelmendi – Ky projektligj është shqyrtuar edhe nga ana e Komisionit për shëndetësi. Në ligjin aktual kemi pasur hapësirën e lokaleve të ndarë 70% me 30 %. Ky ligj nuk ka gjetur zbatim në 90% të rasteve.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë përfundim

Përfundim

1. Projektligjin nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit dhe amendamentet e propozuara nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-155 për sistemin e pagesave

Kryetari – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamentet të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin për sistemin e pagesave dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligjin nr. 04/L- 155 për sistemin e pagesave dhe amendamentet e propozuara nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamentet të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen a kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligjin nr. 04/L- 158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale dhe amendamentet e propozuara nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-189 për ndryshimin plotësimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-189 për ndryshimin, plotësimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen a kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-189 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe amendamentet e propozuara nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen a kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë amendamentet e propozuara nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Të ndryshme

- **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës**

Kryetari – Tha se disa e herë e kemi pasur këtë projektligj në Komisionin për Legjislacion dhe kemi vendosur që kryetari i Komisionit dhe disa anëtarë të tjerë të Komisionit të takohemi me përfaqësuesit e Qeverisë për t’u konsultuar lidhur me këtë projektligj. Ai tha se ky PL është në mospajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë dhe si i tillë nuk mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Po ashtu, edhe formimi i trupave në kuadër të agjencisë, sekretaria ekzekutive edhe trupi i veçantë gjykues në Gjykatën Supreme të Kosovës janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kisha disa takime me iniciuesit e projektligjit të cilët nuk kanë arritur ta arsyetojnë projektligjin dhe kanë kërkuar kohë shtesë për të parë se si do të veprojnë. Ky Projektligj ka ardhur si rezultat i bisedimeve teknike që janë bërë në Bruksel. Po ashtu, më ka arritur një letër nga zëvendëskryeministrja e Kosovës, e cila thotë se duhet ende kohë për harmonizimin me bashkimin Evropian që janë duke vazhduar takimet me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, të cilët e kanë të qartë se përmbajtja e Projektligjit është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe rekomandimi i tyre ka qenë që ky projektligj të kthehet në Qeveri për konsultim.

Armend Zemaj – Ne disa herë e kemi ngritur këtë çështje edhe në Komision edhe në seancën plenare dhe, si deputetë, kemi arritur në përfundim se shumica prej nesh janë kundër Projektligjit për krahasim dhe verifikim të pronës, i cili është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjin e zbatueshëm. Neve na arrijnë letra nga zëvendëskryeministrja, e cila tregon arsyet e ardhjes së këtij projektligji. Mendoj se duhet t’ua bëjmë të qartë edhe Kuvendit, edhe atyre që po i zhvillojnë këto negociata se krijimi i trupave të reja ekzekutive me kompetencë ekzekutive ndërkombëtare nuk mund t’i lejojmë. Verifikimi dhe krahasimi i pronës duhet të bëhet, por duhet të bëhet me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës. Qeveria duhet që ta tërheqë Projektligjin dhe nëse nuk e tërheqin atëherë duhet ta bindim Kuvendin dhe deputetët që mos ta votojnë.

Ardian Gjini – U pajtua me parafolësin dhe shtoi se ne nuk kemi të drejtë të veprojmë në mospajtim me Kushtetutën, pavarësisht marrëveshjeve që bëhen, sepse do të instalojmë që do t’i bëjmë dëm vendit. Ishte i mendimit që kryetari i Komisionit të bisedojë me propozuesin që ta tërheqë këtë projektligj.

Halit Krasniqi – Tha se ne po bëjmë një punë të dobishme për institucionet e shtetit dhe lehtësimin e punëve të Kuvendit. Nganjëherë në përpjekjet tona të motivuara politikisht kemi edhe obstruksione të pa arsyeshme dhe në këtë rast ndahemi edhe si Komision edhe kur kemi qëndrime të arsyeshme kemi edhe kundërshtime të projektligjeve. Kur thuhet se ky projektligj i Qeverisë është në kundërshtim me Kushtetutën nuk mund të jem indiferent. Them se ky projektligj të kthehet te propozuesi dhe të korrigjohet.

Armend Zemaj – Në fjalën e tij të serishme përmendi marrëveshjen e kthimit të dokumenteve kadastral, e që atëherë nuk ka qenë ky ligj. Sa i përket keqpërdorimit të pronës publike e kemi shembullin e Malishevës dhe Bellanicës, ku shqiptarëve ju shpronësuan pronat nga eksponentët qeveritarë.

Kryetari – Ai tha se nenet 6.2, 7.1, 8.2, 9.1, 16.8, 25.2,3,4 dhe 29.1, të Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, janë në mospajtim me amendamentin 22, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 5, të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve, që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës dhe si të tillë duhet të rekomandojmë mos miratimin e Projektligjit.

Haki Demolli – U pajtua me propozimin e Ardian Gjinit që kryetari i Komisionit të kontaktojë me përfaqësuesit e Qeverisë dhe të kërkojë që ta tërheqin Projektligjin dhe nëse nuk hasim në mirëkuptim nga ana e tyre atëherë t'i rekomandojmë Kuvendit mosmiratimin e projektligjit, sepse dispozitat e tij janë në kundërshtim me Kushtetutën.

Jasmina Zhivković – Kërkoi sqarim nga përfaqësuesit e Qeverisë lidhur me përmbajtjen e Projektligjit, nëse përmbajtja e tij rrjedh nga bisedimet që janë zhvilluar në mes të Prishtinës dhe Beogradit? Nëse po, a është respektuar marrëveshja? Nëse ne e hedhim këtë projektligj, a nënkupton kjo se ne po e hedhim edhe marrëveshjen e arritur?

Kryetari – Duke u ndërlidhur me parafolësin theksoi se ne, si Komision, kemi për detyrë që të vlerësojmë që projektligjet a janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjin e zbatueshëm. Nuk mund të paragjykojmë për marrëveshjen teknike. Kisha një takim me përfaqësuesit e Qeverisë dhe ata insistuan se ky projektligj rrjet nga bisedimet teknike dhe konkluzat që janë nxjerrë nga zyra e baroneshës Ashton. Tha se këto konkluzat i kanë arritur me vonesë nga zëvendëskryeministrja.

Halit Krasniqi – Përmbajtja e këtij projektligji ka konotacione dhe implikime, por ne, si grup parlamentar jemi të përkushtuar që këtë Projektligj duhet ta bëjmë në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe nuk ka kompromis me Qeverinë. Jemi të përcaktuar që përmbajtja e këtij Projektligji të jetë në harmoni me Kushtetutën.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 6 vota për dhe 3 abstenime nxori këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të mos e miratojë Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi